



Prishtinë, 31 mars 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_803\_2016

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafin 1.6, Nenin 14, paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së);
- Vendimin\_ V\_799\_2016 për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për OSSH;
- Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes; dhe
- Kërkesën e datës 25 mars 2016 të KEDS –it dorëzuar ZRRE, për miratimin e ngarkesave të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më 31 mars 2016 nxori këtë:

## VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifat dhe ngarkesat, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për vitin relevant tarifor apo SHTE10, i cili fillon nga 1 prilli 2016.

## ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes(KEDS), aplikacionin për ngarkesa të rregulluara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes( DUOS)më datën 25 mars;
  - o Për vendosjen e ngarkesave të rregulluara të operatorit të sistemit të shpërndarjes, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka mbajtur me të licencuarit gjatë periudhës së shqyrtimit tarifor 2016. Këto dokumente janë:
- Raport Konsultativ – Llogaritja e Kostos së Blerjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 shkurt 2016;
  - Raport Konsultativ - Llogaritja e MAR-it të OSSH , i publikuar më datën 24 shkurt 2016; dhe
  - Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i dhjetë i tarifave të energjisë elektrike SHTE10, i publikuar me datën 31 mars 2016;



- II. Duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Struktura e ngarkesave për OSSH, që do të zbatohet nga data 1 prill 2016, përkatësisht në vitin relevant tarifar SHTE10 është dhënë në tabelën e mëposhtme.


Ngarkesat e konsumatorëve të kyçur në OSSH		
Niveli i tensionit	Njësia	Tarifa
35 kV	€c/kWh	1.37
10 kV	€c/kWh	1.64
0.4 kV	€c/kWh	2.46

- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të përkthimeve, do të mbisundojë versioni i gjuhës shqipe.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar,

  
Arsim Janova, anëtar,

  
Qemajl Mustafa anëtar,

  
Besim Sejfi anëtar.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.